

DEKRET
Nr.7437, datë 1.12.1990

**PËR DHËNIEN E TOKËS NË PËRDORIM ME QIRA PERSONAVE JURIDIKË E FIZIKË
TË HUAJ OSE SHQIPTARË ME SELI JASHTË TERRITORIT TË RPSSH, QË
USHTROJNË VEPRIMTARI EKONOMIKE TË PËRBASHKËT ME NDËRMARRJET,
INSTITUCIONET DHE KOOPERATIVAVE TONA NË TERRITORIN E RPSSH**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës;
Me propozimin e Këshillit të Ministrave;

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Toka u jepet në përdorim me qira personave të huaj juridikë a fizikë ose shqiptarë me seli jashtë territorit të RPSSH, që ushtrojnë veprimtari ekonomike të përbashkët me ndërmarrjet, kooperativat dhe institucionet tona në territorin e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

Neni 2

Kriteret e vlerësimit të tokës dhe rregullat e kompetencat e organeve shtetërore për zbatimin e këtij dekreti, caktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 3

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE
TË SHQIPËRISË

SEKRETARI SIHAT TOZAJ	KRYETARI RAMIZ ALIA
---------------------------------	-------------------------------